



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 420/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Synavere Rysha kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Synavere Rysha kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidatja për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Synavere Rysha nga radhët e subjekti politik LDK dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se në Qendrën e Votimit (QV) 2501y, vendvotimi (vv) 09R se është bërë gabim në rezultate e cila thekson se si kandidate në FRK ju kanë shënuar vetëm 17 vota dhe 87 vota ju kanë shënuar kandidatëve tjerë dhe mendon se është dëmtuar për 60 vota.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar Formularin për Rezultatit e Kandidatëve (FRK) të QV 2501y/09R.

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit te ankesës dhe shqyrtimit te shkresave të lëndës, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesja e ankesës nuk ka ofruar dëshmi të asaj natyre për të vërtetuar pretendimet ankimore se ju kanë shënuar vetëm 17 vota e jo siç ka pretenduar në ankesë se i posedon 85 vota.

Andaj nga provat e dëshmuara si dëshmi nga pala ankuese PZAP-i nuk ka mundur ti konstatoj se pretendimet e palës ankuese janë të qëndrueshme. Për arsye të cekura më lartë në mungesë të provave bindëse, PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën në fjalë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 420/2014 më datën 30.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*